# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-458081**
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | "Berishën e ka marrë malli për mua", Dash Sula: Ja çfarë bisedoj në orët e vona me Edi Ramën |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/politika/berishen-e-ka-marre-malli-per-mua-dash-sula-ja-cfare-bisedoj-ne-oret-e--i587109` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 15:07:49 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 15:05:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `0881199780f53237b6c3563f875ec3807ddbb3a43aecf3822e51f01b027babb0` |
| TEKSTI | `29ba4e740b04f8d69c0acd5dddbf320195d913d6273667664e0f3d4e2826d511` |
| PAMJA | `f04c7ef796c941dbeaccdfce8245482bd9185f988955518cdeb1e8e7e7708ad4` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `cce114f74cbc50abfe863dd2167fc5c321c52ab61eed52bb375b78e98ff022ee` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `46a7af3000d16e9ffefcbfa0ca0d8af83c85fda72b67353c14db1e839b49f770` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/cce114f74cbc50abfe863dd2167fc5c321c52ab61eed52bb375b78e98ff022ee`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# “Berishën e ka marrë malli për mua”, Dash Sula: Ja çfarë bisedoj në orët e vona me Edi Ramën

TemA

19 Shtator 2026, 17:05Politika TEMA



Kryeinspektori, Dashnor Sula, në një intervistë në Edicionin Qendror të Lajmeve në televizionin kombëtar Vizion Plus, të moderuar nga Aleksandër Furxhi, ka folur edhe për të shkuarën e tij politike, si dhe marrëdhëniet e sotme me kryeministrin Edi Rama.

I pyetur nga Furxhi në lidhje me akuzat e Berishës, i cili është shprehur se Sula duhet të ishte larguar më herët nga PD-ja, kryeinspektori, me ironi, tha se kryedemokratin e ka marrë malli.

Sula theksoi se ishte vetë zoti Berisha ai i cili prishi gjithçka, duke injoruar primaret.

Sa i përket marrëdhënieve me kryeministrin Rama, Sula tha se ka komunikim të vazhdueshëm, pasi bëhet fjalë për problemet e qytetarëve.

Ndërsa theksoi se edhe me zotin Berisha, në të shkuarën, ka pasur komunikim në orët e vona të natës, por vetëm kur bëhej fjalë për kriza.

**Furxhi:** Ju vini nga politika, keni qenë deputet i Partisë Demokratike, prej shkurtit jeni në këtë pozicion në establishment pranë qeverisë. Z.Berisha dje ka thënë për ju se Dashnor Sula më mirë të kishte ikur më herët. Keni ndonjë përgjigje tani?

**Sula:** Ajo është një dëshirë e zotit Berisha e kahershme me sa duket. Por z.Berisha me sa duket e ka marrë malli shumë për mua, sepse nga marsi i vitit 2025, kur kemi komunikuar për herë të fundit, ishin të famshmet primare të cilat i rrëzoi, i injoroi dhe nuk i respektoi. Tani ka një ndryshim të madh, nëse unë si kryeinspektor i përgjithshëm sot komunikoj me kryeministrin Rama shpeshherë, pothuajse në mënyrë gati të përditshme, jo të përditshme, po gati të përditshme edhe në 12 të natës apo në ora një të natës, pikërisht për shkak të shqetësimit e problematikave që kanë qytetarët, ndaj të cilave kryeministri reagon dhe i drejtohet kryeinspektorit të përgjithshëm për të pasur qasjen e ndjekjes së problemeve ndaj qytetarëve, unë me z.Berisha kam pasur orare më të vona, deri në ora tre po thoshim ndonjëherë, sidomos në kohë krizash. Mund t'i kujtoj zotit Berisha zgjidhjen e krizës së vitit 2007 në zgjedhjen e presidentit, zotit Bamir Topi, në korrik...

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[“Tirana s’mund t’ua japë dot lirinë, por mund t’i nderojë”- Veliaj i propozon Këshillit Bashkiak titullin ‘Qytetar Nderi’ për liderët e UÇK]

14:27 Politika / 22 komente

Kryeministri Rama vizitë në SHBA, merr pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së

13:35 Politika / 20 komente

[Pyetjet e porositura të PD-së dhe regjia që po e bën Berishën qesharak]

13:25 Politika / 21 komente

Parlamenti Europian mbështet Shqipërinë: Hapa të shpejtë drejt anëtarësimit në BE

12:35 Politika / 14 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.